

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarës A.K., nga fshati ..., Komuna e Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par 6 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2646/2017, të dt.20.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 29.08.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I.** Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, e sipas detyrës zyrtare **ndryshohet**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2646/2017, të dt.20.02.2018, përkitazi me kualifikimin juridik, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarën A.K., e shpallë fajtores për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par 6 dhe 1 të KPK.

**II.** Sa i përket ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, e njëjta refuzohet si e pa bazuar.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2646/2017, të dt.20.02.2018, është shpallur fajtores e akuzuara A.K., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par 6 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se e akuzuara në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Të dëmtuari, M.B., H.B., L.K., A.S. dhe N.H., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 90.88 €, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Ferizaj, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarës ti shqiptohet një dënim më i lartë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.810/2018, të datës 31.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarës ti shqiptohet një dënim më i lartë.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale, duke u bazuar edhe në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarën e ka shpallur fajtores për veprën penale e cila i vihet në barrë, mirëpo dënimi i shqiptuar të akuzuarës është shumë i butë, krahasuar me peshën e veprës penale të kryer, përgjegjësisë penale të saj, si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese sikurse janë, se e akuzuara e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, se e njëjta asnjëherë më parë nuk ka qenë e dënuar, se është nënë e tre fëmijëve, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar vetëm peshën e veprës penale të kryer, andaj, duke patur parasysh se ditën kritike e akuzuara A.K., ka rrezikuar komunikacionin publik dhe jetën e njerëzve gjerë sa ka qenë duke lëvizur në rrugën “Brahim Ademi” në Ferizaj, nga pakujdesia kur ka arritur në përfundim të rrugës ku komunikacioni zhvillohet në dy korsi në drejtim të lëvizjes, ka goditur automjetin transportues të markës VWLT me targa 05-445-AD, të cilin e drejtonte A.S., ku lëndime trupore kanë pësuar Mustafë Bytyqi, L.K. dhe N.H., lëndime këto të përshkuara në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.04.10.2007, konsiderojmë se dënimi i shqiptuar me kusht është shumë i butë, dhe se me një dënim të tillë nuk do të mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se e akuzuara e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, se asnjëherë më parë nuk ka qenë e dënuar me vendim të formës së prerë, se është nënë e tre fëmijëve, ndërsa si rrethana rëndese ka vlerësuar peshën konkrete të veprës penale të kryer, andaj, në prani të këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore nga neni 75 dhe

76 të KPK, përkitazi me zbutjen e dënimeve, dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese sikurse pretendon prokuroria në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e saj, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.804/2018, të datës 29.08.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**